



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Ekstra XII

SHTATOR

2003

Akte të papublikuara

Korrik – Dhjetor 1998

	Faqe
Vendim i KM nr.544, datë 29.7.1998	Për riorganizimin institucional të fondit të zhvillimit shqiptar 7
Vendim i KM nr.546, datë 28.8.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshilit të Ministrave nr.286, datë 30.05.1994 “Për administrimin e sendeve që kalojnë në dobi të shetit nga kundërvajtjet administrative”, ndryshuar me vendimet e Këshilit të Ministrave nr.405, datë 15.8.1994 dhe nr.380, datë 30.4.1998 7
Vendim i KM nr.548, datë 28.8.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshilit të Ministrave nr.57, datë 2.2.1996 “Për disa të drejta e detyra që rrjedhin nga ligji nr.7978, datë 26.7.1995 “Për forcat e armatosura të Republikë së Shqipërisë” 8
Vendim i KM nr.549, datë 28.8.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.473, datë 3.10.1994 “Për prokurimin me sipërmarrje të shërbimeve publike të funeralit, mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta, dekorit dhe varrezave publike të dëshmorëve”, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.586, datë 5.12.1994 8

Vendim i KM nr.550, datë 28.8.1998	Për rritjen e kuotës së trajtimit të dhuruesve të gjakut	9
Vendim i KM nr.553, datë 28.8.1998	Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shoqërive tregtare, të krijuara nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore	9
Vendim i KM nr.573, datë 29.7.1998	Për shpalljen e ujëmbledhësit të Bovillës “Objekt të rëndësishëm shtetëror	10
Vendim i KM nr.577, datë 15.9.1998	Për rivendosjen e rendit kushtetues të cënuar nga grupe të armatosura	11
Vendim i KM nr.586, datë 8.9.1998	Për miratimin e kompanisë me të cilën do kontraktohet ndërtimi i hidrocentralit të Bushatit dhe procedurat deri në lidhjen e kontrates	11
Vendim i KM nr.591, datë 8.9.1998	Për rritjen e çmimeve të librave shkollorë të arsimit parauniversitar	12
Vendim i KM nr.594, datë 19.9.1998	Për disa shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.592, datë 22.12.1997 “Për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve të larta shtetërore dhe trajtimin me pagë të efektivave të këtyre shërbimeve”	13
Vendim i KM nr.595, datë 21.9.1998	Për ngritjen e Komitetit Kombëtar të Etikës Mjekësore	13
Vendim i KM nr.596, datë 21.9.1998	Për mbylljen e zyrave të hipotekave dhe për kalimin e veprimtarisë së tyre në zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme	14
Vendim i KM nr.606, datë 25.9.1998	Për administrimin e dhurimeve financiare e materiale nga persona fizikë e juridikë, vendas a të huaj për institucionet e dëmtuara në ngjarjet e 13 dhe 14 shtatorit	15
Vendim i KM nr.616, datë 10.10.1998	Për krijimin e lehtësirave të veprimtarisë së avionëve dhe anijeve ushtarake të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Republikën e Shqipërisë	15
Vendim i KM nr.621, datë 25.9.1998	Për krijimin e komitetit të konsulencës dhe të transparencës për privatizimin e sektorëve me rëndësi të vecantë të ekonomisë	16
Vendim i KM nr.622, datë 21.9.1995	Për shpejtimin e zgjidhjes së problemit të familjeve të pastreha	17
Vendim i KM nr.623, datë 8.10.1998	Për dhënien e lejes për funksionimin e institucioneve arsimore private	18
Vendim i KM nr.636, datë 8.10.1998	Për krijimin e Komitetit Shqiptar për lehtësimin e procedurave të Tregëtisë së Jashtme, “ALBA-PRO”	19
Vendim i KM nr.644, datë 18.10.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.775, datë 28.10.1996 “Për krijimin e Këshillit Kombëtar të Ujit	19
Vendim i KM nr.647, datë 18.10.1998	Për caktimin e tarifave në shërbimin shëndetësor stomatologjik	20

Vendim i KM nr.663, datë 26.10.1998	Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.12, datë 9.1.1993 “Për miratimin në parim të projektit të bankës botërore për lehtësimin e varfërisë së zonave rurale”	21
Vendim i KM nr.674, datë 26.10.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.125, datë 13.3.1995 “Për financimin e kujdesit shëndetësor, për masat parandaluese e mjekuese ndaj sëmundjeve ngjitëse”	22
Vendim i KM nr.675, datë 26.10.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.551, datë 28.8.1998 “Për veprimet e kthimit të arit të grabitur nga gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore”	22
Vendim i KM nr.684, datë 28.10.1998	Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.446, datë 9.7.1998 “Për procedurat e privatizimit me ankand të të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”	23
Vendim i KM nr.687, datë 18.10.1998	Për masën e shpërblimit që u jepet shtetasve të ndryshëm të cilët japin informacion për grumbullimin e armëve dhe të municioneve luftarake	23
Vendim i KM nr.688, datë 26.10.1998	Për lejimin e dhënies së njëhershme të ndihmës ekonomike për zonat që bllokohen në periudhën e dimrit	24
Vendim i KM nr.693, datë 26.10.1998	Për procedurën e realizimit të të ardhurave nga tatimi mbi ndërtesat	27
Vendim i KM nr.702, datë 3.11.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.595, datë 29.12.1993 “Për kriteret e shpalljes së konkurseve me karakter kombëtar e lokal dhe dhënien e çmimeve për to”	29
Vendim i KM nr.723, datë 19.11.1998	Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”	29
Vendim i KM nr.725, datë 19.11.1998	Për privatizimin e Bankës Kombëtare Tregtare, sh.a	30
Vendim i KM nr.726, datë 19.11.1998	Për zbatimin e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë	30
Vendim i KM nr.727, datë 19.11.1998	Për krijimin e Komitetit të Sigurisë së Aviacionit Civil për aeroportin	31
Vendim i KM nr.728, datë 19.11.1998	Për hapjen e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në universitetin “Aleksander Xhuvani” të Elbasanit	32
Vendim i KM nr.730, datë 19.11.1998	Për miratimin e rritje së kuotës të anëtarësimit në Fondin Monetar Ndërkombëtar	32
Vendim i KM nr.731, datë 11.11.1998	Për krijimin e drejtorisë së kontrollit të brendshëm administrativ	33
Vendim i KM nr.743, datë 27.11.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.235, datë 15.5.1995 “Për krijimin e Këshillit Kombëtar të Rrugëve”	35

V E N D I M
Nr.544, datë 29.7.1998

PËR RIORGANIZIMIN INSTITUCIONAL TË FONDIT TË ZHVILLIMIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 21.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Riorganizimi institucional i Fondit të Zhvillimit Shqiptar në funksion të projekteve të reja të bëhet duke u mbështetur në komponentët:

- a) punime të infrastrukturës rurale dhe urbane;
- b) kredia e vogël rurale;
- c) kredia e vogël urbane.

2. Ngarkohet Fondi i Zhvillimit Shqiptar të përgatisë kuadrin e nevojshëm ligjor për riorganizimin institucional dhe t’ia paraqesë për miratim Këshillit të Ministrave, brenda muajit nëntor 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.546, datë 28.8.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.286, DATË 30.5.1994
“PËR ADMINISTRIMIN E SENDEVE QË KALOJNË NË DOBI TË SHITETIT NGA
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE”, NDRYSHUAR ME VENDIMET E KËSHILLIT TË
MINISTRAVE NR.405, DATË 15.8.1994 DHE NR.380, DATË 30.4.1998

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7941, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.286, datë 30.5.1994, në fund të pikës 4/1 shtohet një fjali si vijon:

“Pas ankandit të parë, çmimet e shitjes nuk duhet të jenë më ulët se 15 për qind, krahasuar me çmimet në fuqi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.548, datë 28.8.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.57, DATË 2.2.1996
“PËR DISA TË DREJTA E DETYRA QË RRJEDHIN NGA LIGJI NR.7978, DATË 26.7.1995 “PËR
FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË””

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.57, datë 2.2.1996, në pikën 1, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Shtetasit shqiptarë që janë të aftë e brenda moshës për kryerjen e shërbimit ushtarak aktiv, mund të përjashtohen nga kryerja e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, në rast se ata paguajnë njëherësh një shumë të hollash të barabartë me dyfishin e shpenzimeve që duhen për mbajtjen e një ushtari rrogëtar”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.549, datë 28.8.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.473, DATË 3.10.1994
“PËR PROKURIMIN ME SIPËRMARRJE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË FUNERALIT,
MIRËMBAJTJES SË SIPËRFAQEVE TË GJELBËRTA, DEKORIT DHE VARREZAVE PUBLIKE
TË DËSHMOREVE”, NDRYSHUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.586,
DATË 5.12.1994

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.473, datë 3.10.1994, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.586, datë 5.12.1994, në pikën 8, shfuqizohen fjalët “dhe për qytetin e Tiranës edhe mirëmbajtja e parqeve dhe e sipërfaqeve të gjelbërta”.

2. Bashkia e Tiranës, nëpërmjet ndërmarrjes së gjelbërimit të administrojë dhe të trajtojë me shërbime objektet e karakterit kombëtar si: Varrezat e Kombit, Parkun e Madh dhe Kopshtin Zoologjik.

3. Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërta në qytet, e veprave ndërtimore e ujore, si dhe sektori i prodhimit të bimësisë dekorative të kalojë në sipërmarrje, sipas dispozitave në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTR
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.550, datë 28.8.1998

PËR RRITJEN E KUOTËS SË TRAJTIMIT TË DHURUESVE TË GJAKUT

Në mbështetje të ligjit nr.8032, datë 16.11.1995 “Për shërbimin e transfuzionit dhe kontrollit të gjakut, produkteve të tij dhe transplantimeve”, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Shëndetësisë të kryejë trajtimin e dhuruesve të gjakut në kuotën e vleftës prej 2 850 lekë (për njësi prej 400 ml gjak).
2. Trajtimi ushqimor të kryhet në shumën prej 150 lekësh për çdo dhurim gjaku.
3. Efektet financiare, që rrjedhin nga ky vendim, mbulohen nga buxheti i institucioneve shëndetësore. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.553, datë 28.8.1998

PËR REGJISTRIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME TË SHOQËRIVE TREGTARE, TË KRIJUARA NGA TRANSFORMIMI I NDËRMARRJEVE SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 2 të ligjit nr.8237, datë 1.9.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7326, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshuar me dekretin nr.1195, datë 14.8.1995, ligjin nr.8099, datë 28.3.1996, dekretin nr.1631, datë 1.11.1996 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pasuritë e paluajtshme, pronë shtetërore, të vendosura si kontribut në natyrë në kapital themeltar të shoqërive tregtare, të krijuara nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore, në bazë të ligjit nr.7292, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme si pasuri e këtyre shoqërive.
2. Regjistrimi i pasurive të paluajtshme të bëhet në bazë të urdhrit të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit. Ky urdhër, si rregull, duhet të përmbajë të dhënat për vlerën, kufijtë, sipërfaqen dhe vendndodhjen e pasurisë së paluajtshme, për të cilën kërkohet regjistrimi.
3. Bashkëlidhur urdhrit të lartpërmendur, të paraqiten për regjistrim në regjistrin e pasurive të paluajtshme, vendimi i gjykatës për regjistrimin në regjistrin tregtar, bashkë me aktet me të cilat krijohet shoqëria tregtare, si dhe planrilevimi i pasurisë së paluajtshme për të cilën kërkohet regjistrimi.
4. Kur një shoqëri tregtare disponon pasuri të paluajtshme në zona të ndryshme të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, regjistrimi i tyre bëhet pranë zyrës së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, për të cilën kërkohet regjistrimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.573, datë 29.7.1998

PËR SHPALLJEN E UJËMBLEDHËSIT TË BOVILLËS “OBJEKT TË RËNDËSISHËM SHTETËROR”

Në bazë të ligjit nr.7550, datë 20.1.1992 “Për policinë e objektit”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ujëmbledhësi i Bovillës shpallet “Objekt i rëndësishëm shtetëror” dhe merret në ruajtje nga Ministria e Rendit Publik, për t’u ruajtur me forcë policie.

Objekti i ruajtjes do të jetë diga e ndërtuar mbi lumin Tërkuzë, në grykën e ngushtë, në afërsi të fshatit Zall-Herr, nënobjektet, kullat, galeritë e marrjes së ujit, shkarkuesi automatik sipërfaqësor, galeria e kaptizimit të ujit dhe tuneli i devijimit.

2. Marrja në ruajtje e objektit të bëhet në bazë të ligjit nr.7550, datë 20.1.1992 “Për policinë e objekteve”, neni 3, shkronja “b”, me marrëveshjen e Ministrisë së Rendit Publik dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe të Transportit.

3. Shpenzimet që nevojiten për efektivin e policisë për vitin 1998 e që arrijnë vlerën 1 789 348 lekë të përballohen nga fondet e Buxhetit të Shtetit, të akorduara për ndërtimin e veprës “Ujëmbledhësi i Bovillës”.

4. Për vitet në vazhdim fondet për ruajtjen e objektit do të përballohen nga subjekti që do ta ketë këtë objekt në administrim.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe të Transportit, Ministria e Rendit Publik dhe Bashkia e Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Pagesat për periudhën 1.8.1998 deri më 31.12.1998 (në bazë të urdhrit nr. 649, datë 28.3.1998 të Ministrit të Rendit Publik)

Për 8 policë	8 x 30 154 x 5	= 1 206 160 lekë
Për 1 oficer	1 x 34 475 x 5	= 172 375 lekë
Shuma 1		= 1 378 535 lekë

2. Tarifat për shpenzime operative:

- Për veshmbathje	11 126 lekë
- për pajisje armatimi	4 583 lekë
- për pajisje ndërlidhjeje	8 334 lekë
- për ushqim	18 750 lekë
Shuma	42 793 lekë/1 person, 5 muaj
	x 8

Shuma	342 344
TVSH 20%	68 469

Shuma 2	410 813 lekë
Shuma totale (1+2)	1. 789 348 lekë

V E N D I M
Nr.577, datë 15.9.1998

PËR RIVENDOSJEN E RENDIT KUSHTETUES TË CËNUAR NGA GRUPE TË ARMATOSURA

Këshilli i Ministrave, pasi diskutoi me përgjegjësi ngjarjet e ndodhura gjatë datave 13 dhe 14 shtator të vitit 1998, me detyrimin e vet për mbrojtjen e rendit kushtetues, në mbështetje të kompetencave që burojnë nga ligji nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”

V E N D O S I:

1. Të konsiderojë grusht shteti ngjarjet e datës 14 shtator 1998, nëpërmjet të cilave me veprime të organizuara, të dhunshme dhe të armatosura u realizua pushtimi me forcë dhe plaçkitja e ndërtesave të selive të Kuvendit Popullor, të Kryesisë së Kuvendit Popullor, të Këshillit të Ministrave, të Gjykatës Kushtetuese, të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të Ministrisë së Drejtësisë, të Ministrisë së Financave dhe të Radiotelevizionit Shqiptar, si dhe goditja me armë e Ministrisë së Rendit Publik të nxitura, të organizuara dhe të drejtuara nga Sali Berisha dhe bashkëpunëtorët e tij.

2. Të eliminojë në mënyrë përfundimtare, ndërmjet strukturave përkatëse ligjore të shtetit, të gjitha tentativat dhe veprimet që vazhdojnë të synojnë përmbyshjen me anë të dhunës dhe armëve, të rendit kushtetues dhe të institucioneve legjitime të shtetit.

3. Ministria e Rendit Publik të vërë në dispozicion forcat e saj dhe t'i përgjigjet me efikasitet kërkesave të organeve të prokurorisë për ndjekjen penale të të gjithë personave organizatorë, ekzekutorë, shtytës dhe ndihmës, pjesëmarrës në këtë grusht shteti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.586, datë 8.9.1998

**PËR MIRATIMIN E KOMPANISË ME TË CILËN DO TË KONTRAKTOHET NDËRTIMI I
HIDROCENTRALIT TË BUSHATIT DHE PROCEDURAT DERI NË LIDHJEN E KONTRATËS**

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të miratojë ofertën e kompanisë kineze HAINAN SIT për kontraktimin e ndërtimit të hidrocentralit të Bushatit.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe e Privatizimit, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Bashkëpunimit Ekonomik dhe të Tregtisë, të studiojë dhe analizojë efektivitetin për realizimin e këtij projekti, në kushtet aktuale të sistemit elektroenergjitik. Në bazë të studimit dhe të analizave që do të bëhen, ngarkohen ministrinë e sipërpërmendura të negociojnë me Palën kineze për financimin dhe realizimin e hidrocentralit të Bushatit.

3. Këshilli i rrethit të Shkodrës dhe KESH-i, në zbatim të ligjit nr.7848, datë 25.7.1994 "Për shpronësimet për interes publik", duke filluar nga muaji shtator 1998, të fillojnë përgatitjen e procedurave për shpronësimin e sipërfaqes ku do të ndërtohet hidrocentrali i Bushatit.

4. Ministria e Punëve të Jashtme të njoftojë, brenda muajit shtator 1998, Republikën e Malit të Zi për projektin e hidrocentralit të Bushatit.

5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.89, datë 19.2.1996 "Për miratimin e firmës me të cilën do të kontraktohet ndërtimi i hidrocentralit të Bushatit", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M

Nr.591, datë 8.9.1998

PËR RITJEN E ÇMIMEVE TË LIBRAVE SHKOLLORË TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çmimet e shitjes me pakicë të librave shkollorë të arsimit 8-vjeçar rriten 40 për qind dhe ato të arsimit të mesëm rriten 50 për qind, mesatarisht kundrejt çmimeve të shitjes së tyre me pakicë që janë në fuqi, të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.68, datë 30.1.1995 “Për rritjen e çmimeve të librave shkollorë të arsimit 8-vjeçar dhe të mesëm”.

2. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të llogarisë çmimet e reja të këtyre librave dhe t’i shpallë ato për zbatim, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi. Këto çmime të zbatohen për të gjithë librat shkollorë të arsimit parauniversitar që janë në qarkullim dhe që vazhdojnë të shtypen.

3. Diferencat ndërmjet çmimeve të reja dhe atyre të mëparshme, për sasi të që janë në gjendje pranë subjekteve shtetërore përkatëse të shitjes me pakicë dhe të shtypura deri më 31.5.1998, të derdhen detyrimisht në Buxhetin e Shtetit.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës që, në bashkëpunim me organet përkatëse të pushtetit lokal, të ndjekë dhe të marrë masa të nevojshme për kryerjen e rregullt të inventarizimeve, sistemin e diferencave të çmimeve dhe derdhjen e tyre në Buxhetin e Shtetit, gradualisht me shitjen e librave shkollorë gjendje me çmimet e reja.

5. Diferencat ndërmjet shpenzimeve të prodhimit e të shpërndarjes së librave shkollorë të arsimit parauniversitar dhe çmimeve përkatëse me pakicë, të caktuara sipas këtij vendimi, të vazhdojnë të subvencionohen nga Buxheti i Shtetit, sipas shumës përkatëse të miratuar në Buxhetin e Shtetit.

6. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të nxjerrë, brenda muajit shtator 1998, udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr.594, datë 19.9.1998

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.592, DATË 22.12.1997 “PËR RUAJTJEN DHE SHOQËRIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE DHE TRAJTIMIN ME PAGË TË EFEKTIVAVE TË KËTYRE SHËRBIMEVE”

Në mbështetje të ligjit nr.7602, datë 9.9.1992 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.592, datë 9.9.1992 bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 2, pas fjalëve “Ministrit të Punëve të Jashtme”, shtohen fjalët “Prokurorit të Përgjithshëm”.

2. Pika 4 ndryshohet si vijon:

“Për personalitetet e tjera shtetërore, që përfshihen në shkronjën “b” të neneve 2 dhe 3 të ligjit nr.7602, datë 9.9.1992 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me përjashtim të atyre të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, si dhe të prokurorit të rrethit të Tiranës, u bëhet ruajtja e afërt fizike me një ose me shumë shoqërues personalë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Nano

Fatos

V E N D I M
Nr.595, datë 21.9.1998

PËR NGRITJEN E KOMITETIT KOMBËTAR TË ETIKËS MJEKËSORE

Në mbështetje të nenit 35 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të krijohet Komiteti Kombëtar i Etikës Mjekësore (KKEM), si organ këshillimor i Ministrisë së Shëndetësisë.
 2. Komiteti Kombëtar i Etikës Mjekësore përbëhet nga 11 anëtarë. Kryesia dhe anëtarët e këtij komiteti caktohen nga Ministri i Shëndetësisë.
 3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.596, datë 21.9.1998

PËR MBYLLJEN E ZYRAVE TË HIPOTEKAVE DHE PËR KALIMIN E
VEPRIMTARISË SË TYRE NË ZYRAT E REGJISTRIMIT TË
PASURISË SË PALUAJTSHME

Në mbështetje të neneve 56 e 57 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Zyrat e hipotekës mbyllen dhe veprimtaria e tyre të realizohet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të rretheve.
Zyrat e hipotekave hiqen nga struktura e Ministrisë së Drejtësisë duke pakësuar organikën përkatëse.
Objektet, ndërtesat dhe mjediset pronë shtetërore, që kanë pasur në përdorim zyrat e hipotekave, mbeten në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë për t’u përdorur si zyra të përmbarimit ose dhe për veprimtari të tjera të kësaj ministrie.
2. Ministria e Drejtësisë dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të marrin masa për transferimin e dokumenteve të zyrave të hipotekës, duke siguruar respektimin e rregullave për dorëzimin e tyre.
3. Në zbatim të këtij vendimi, Ministri i Drejtësisë me urdhër të veçantë përcakton:
 - 3.1. Punonjësit e hipotekave, të cilët sipas numrit të propozuar nga kryeregjistruesi, do të vazhdojnë veprimtarinë pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme deri në përfundimin e regjistrimit fillestar,

duke lidhur kontratë pune të kushtëzuar me afatin e mësipërm, përveç kur mbahen për plotësimin e vendeve vakante.

3.2. Punonjësit e hipotekave, të cilët ndërpresin marrëdhëniet e punës për shkak të mbylljes së veprimtarisë.

3.3. Destinacionin e mjeteve të punës që mbeten në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë.

3.4. Mënyrën e veprimit me ndërtesat dhe mjediset e zyrave të hipotekave, që nuk janë pronë shtetërore.

4. Nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë pakësohet fondi i pagave dhe i shpenzimeve të tjera të planifikuara për zyrat e hipotekave për vitin 1998, në pjesën e papërdorur deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

Nga vlerat e mësipërme në buxhetin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, shtohet pjesa proporcionale, e cila i korrespondon numrit të punonjësve të hipotekave, që do të aktivizohen me kontratë, ndërsa pjesa tjetër i kalon Buxhetit të Shtetit.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.303, datë 16.4.1996 pika 2, nr.426, datë 17.6.1996, nr.676, datë 14.10.1996, nr.580, datë 22.12.1997, nr.174, datë 18.4.1995, pika 4, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr.606, datë 25.9.1998

PËR ADMINISTRIMIN E DHURIMEVE FINANCIARE E MATERIALE
NGA PERSONA FIZIKË E JURIDIKË, VENDAS A TË HUAJ PËR
INSTITUCIONET E DËMTUARA NË NGJARJET E 13 DHE 14
SHTATORIT

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dhurimet financiare nga persona fizikë e juridikë, vendas a të huaj, për përballimin e dëmeve të pësuar në aparatin e Këshillit të Ministrave dhe në institucionet e tjera shtetërore, për shkak të veprimeve të dhunshme e të armatosura të pjesëmarrësve në ngjarjet e datave 13 dhe 14 shtator të vitit 1998, të depozitohen në dy llogari bankare të posaçme, përkatësisht në lekë dhe në valutë.

2. Përdorimi i dhurimeve të depozituara, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për prokurimet publike, bëhet me miratimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave ose nga personi i autorizuar prej tij. Dhurimet financiare janë tërësisht të përdorshme nga institucioni përfitues, jashtë fondeve limit të kushtëzuara.

3. Numrat e llogarive bankare, të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, të bëhen publike nëpërmjet mjeteve të informacionit publik.

4. Dhurimet materiale të administrohen në përputhje me dispozitat përkatëse në fuqi, për miradministrimin e vlerave materiale e monetare dhe të përdoren me miratimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave ose personit të autorizuar prej tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr.616, datë 10.10.1998

PËR KRIJIMIN E LEHTËSIRAVE TË VEPRIMTARISË SË AVIONËVE
DHE ANIJEVE USHTARAKE TË ORGANIZATËS SË TRAKTATIT TË
ATLANTIKUT VERIOR (NATO) NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 7 të dekretit nr.4650, datë 9.3.1970 “Për kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.8374, datë 15.7.1998 “Për përdorimin e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.7816, datë 20.4.1994 “Për ratifikimin e dokumentit kuadër të partneritetit për paqe” dhe të rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara nr.1199 për Kosovën, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit të hapësirës ajrore dhe aeroporteve të Republikës së Shqipërisë për fluturimin e avionëve dhe helikopterëve ushtarakë të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior deri më datë 31.12.1998 për kryerjen e veprimeve të tyre në ndihmë të zgjidhjes së krizës së Kosovës dhe për rritjen e sigurisë në rajon.

2. Miratimin e hyrjes e lundrimit në ujërat territoriale e të brendshme dhe përdorimit të porteve detare të Republikës së Shqipërisë nga ana e anijeve ushtarake të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior deri më datë 31.12.1998 për kryerjen e veprimtarisë së tyre në ndihmë të misionit të sigurisë në rajon.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Punëve Publike dhe e Transportit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr.621, datë 25.9.1998

PËR KRIJIMIN E KOMITETIT TË KONSULENCËS DHE TË TRANSPARENCËS PËR
PRIVATIZIMIN E SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË TË EKONOMISË

Në mbështetje të nenit 13 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike të dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e komitetit të konsulencës dhe të transparencës, për privatizimin e sektorëve me rëndësi të veçantë të ekonomisë.

2. Ky komitet ka objekt të veprimtarisë së vet:

- Të vazhdojë funksionet e konsulencës dhe të transparencës së procedurave të vendosura për privatizimin sipas legjislacionit në fuqi.

- Të sigurojë dhe të udhëzojë të gjitha proceset e privatizimit, të parashikuara në strategjinë e privatizimit, të miratuar me ligjin nr.8306, datë 14.3.1998, duke garantuar që procedurat udhëzuese për këto çështje të jenë në zbatim të legjislacionit në fuqi për privatizimin, duke ngritur për këtë qëllim grupe të veçanta pune.

- Të sugjerojë nisma në fushën ligjore, fiskale dhe ekonomike, të nevojshme për të favorizuar

suksesin e programit të privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë të ekonomisë shqiptare.

- T'i propozojë Komitetit për Politikën Ekonomike, pranë Këshillit të Ministrave, kalendarin e operacioneve të privatizimit.

3. Komiteti përbëhet nga 13 anëtarë, dy përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, një përfaqësues nga Ministria e Financave, një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, dy përfaqësues nga organet përkatëse, që përgjigjen për administrimin e pronës shtetërore, të cilët kanë në vartësi dhe gjashtë anëtarë të tjerë, që do të caktohen ndërmjet konsulentëve financiarë, ligjor dhe të marketingut, të seleksionuar në nivel ndërkombëtar nëpërmjet procedurave konkurruese të njohura nga Banka Botërore.

4. Komiteti drejtohet nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, i cili mund t'ia delegojë këtë detyrë Zëvendësministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

5. Brenda 15 ditëve nga kërkesa e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit, ministrinë dhe institucionet e përcaktuara në pikën 3, duhet të dërgojnë propozimet për përfaqësuesit e tyre pranë Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Në rastin kur përfaqësuesi i propozuar nuk merr pjesë në mbledhjet e komitetit, ministri përkatës siguron zëvendësimin e tij në kohën e duhur.

6. Shoqëritë e përfshira në programin e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë, si dhe ministrinë e tjera të interesuara, duhet t'i sigurojnë komitetit të gjitha informacionet me natyrë ligjore, financiare, kontabile dhe ekstrakontabile, të nevojshme për zhvillimin e detyrave që i janë ngarkuar këtij komiteti.

7. Anëtarët e komitetit dhe të gjithë personat që marrin pjesë në mbledhjet e tij janë të detyruar të ruajnë sekretin për informacionet e siguruar dhe të mos i përdorin ato për qëllime të tjera, të ndryshme nga ato të veprimtarisë institucionale të këtij komiteti.

8. Organizimi dhe funksionimi i komitetit përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe i Privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr.622, datë 21.9.1995

Për shpejtimin e zgjidhjes së problemit të familjeve të pastreha

Në mbështetje të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S i:

1. Enti Kombëtar i Banesave (EKB) dhe Banka e Kursimeve (BK) të krijojnë komisione të përbashkëta pune për lidhjen e kontratave përfundimtare për banesat e ndërtuara nga EKB-ja për familjet e pastreha. Lidhja e kontratave me familjet e pastreha, transferimi i dosjeve dhe kalimi i pronësisë së banesave nga EKB-ja në BK, të përfundojë brenda vitit 1998. Realizimi i këtyre procedurave rregullohet me marrëveshje të veçantë ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave dhe Bankës së Kursimeve.

2. Organet e pushtetit lokal dhe Instituti i Integritetit të të Përndjekurve Politikë të bëjnë, përkatësisht ndarjen e apartamenteve të përfunduara dhe të atyre në proces. Listat respektive t'i dërgohen EKB-së brenda muajit tetor 1998.

3. Organet e pushtetit lokal, pas njoftimit nga EKB-ja nxjerrin, për banesat e ndërtuara nga ky ent dhe të zëna me forcë nga qytetarët, urdhrin administrativ për lirimin e tyre dhe e dërgojnë për ekzekutim në organet e Ministrisë së Rendit Publik.

4. Fondet buxhetore, të depozituara dhe të parashikuara për t'u depozituar gjatë vitit 1998 në BK, për llogari të kontributit të shtetit për familjet e pastreha, në masën jo më pak se 90 për qind, të përdoren për ndërtimin e apartamenteve tip dhe për blerjen e apartamenteve për të pastrehët, qiramarrës në banesat e ish-pronarëve dhe deri në 10 për qind për nevojat emergjente në kategoritë e tjera të të pastrehëve. Ndarja e

përdorimit të këtyre fondeve sipas rretheve, të bëhet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave. Këto fonde të destinohen për ndërtime banesash në rrethet, ku kostoja e ndërtimit të tyre nga EKB-ja është më e ulët se çmimi i tregut dhe për blerjen nga tregu i lirë në ato rrethet, ku çmimi i tregut të lirë është më i ulët se kostoja e banesave të ndërtuara nga EKB-ja. Financimi i ndërtimit ose i blerjes së banesave dhe lidhja e kontratave përfundimtare me qytetarët të bëhet nga BK-ja, në bazë të situacioneve ose akteve të blerjes, të miratuara nga EKB-ja dhe sipas listave të dërguara nga organet e pushtetit lokal. 4 për qind të të ardhurave nga shitja e banesave, në fund të çdo viti t'i kalojnë Entit Kombëtar të banesave, për shpenzimet operacionale të këtij enti, me përjashtim të rasteve kur kjo përqindje është marrë prej Entit Kombëtar të Banësive në formën e paradhënies.

5. Kontratat e shitjes së banesave të ndërtuara ose të blera me fonde shtetërore, si dhe të banesave të ndërtuara me fondet e Bankës Botërore të lidhen në monedhën “lekë shqiptare”, sipas çmimeve të përcaktuara nga dispozitat në fuqi, në varësi të kategorisë së të pastrehëve. Për familjet, të cilat gëzojnë të drejtën e përfitimit falas nga shteti, akti i detyrimit financiar lidhet me vlerën neto që del nga diferenca ndërmjet çmimit të banesës dhe shumës së përfitimit falas.

Në ato rrethet ku kostoja e ndërtimit nga EKB-ja është më e lartë se çmimi i tregut dhe diferenca ndërmejt tyre është më e madhe se përfitimi falas për familjet e pastreha, shuma e detyrimit financiar do të jetë e barabartë me çmimin e tregut.

Bazuar në këto kritere, të bëhet ristrukturimi i kredisë së pashlyer nga qytetarët, të cilët kanë përfituar banesë me fondet shtetërore. Shuma e kredisë, që rezulton e pashlyer pas ristrukturimit, të ndahet në këste të barabarta për periudhën e mbetur të shlyerjes.

6. Në rast se qytetarët nuk pranojnë lidhjen e kontratave të shitblerjes së banesave të ndërtuara, atëherë ata humbasin të drejtën e përfitimit të pronësisë së banesës së ndërtuar me fonde shtetërore dhe trajtohen si qytetarë që kanë zënë me forcë banesat e ndërtuara me fondet shtetërore.

7. Pjesa e kredisë së akorduar nga qeveria greke të përdoret për të pastrehët e krijuar nga humbja e parave në skemat piramidale.

8. Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe e Tregtisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme të përgatisin kuadrin e nevojshëm ligjor për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Fondin e Zhvillimit Social të Këshillit të Europës.

9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve Publike dhe e Transportit dhe Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe e Tregtisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr.623, datë 8.10.1998

PËR DHËNIEN E LEJES PËR FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE

Në mbështetje të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe nenit 6 të ligjit nr.8387, datë 30.7.1998 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar””, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për funksionimin e institucionit arsimor privat të niveleve të arsimit 8-vjeçar e të mesëm, “Shkolla italiane “Galileo-Galilei”” e shoqatës “Galileo-Galilei”, adresa: “Parku Kombëtar”, Tiranë.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të kontrollojë procesin mësimor dhe zbatimin e ligjshmërisë në fushën arsimore të këtij institucioni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr.636, datë 8.10.1998

PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHQIPTAR PËR LEHTËSIMIN E PROCEDURAVE TË
TREGTISË SË JASHTME, “ALBA-PRO”

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me
propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e komitetit shqiptar për lehtësimin e procedurave të tregtisë së jashtme,
shkurtimisht i emërtuar “ALBA-PRO” dhe miratimin e statutit të këtij Komiteti.
2. Në përbërje të bordit të “ALBA-PRO-së” të marrin pjesë:

Zëvendësministri i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë	kryetar
Ekspert nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	zëvendëskryet
	ar
Ekspert nga Ministria e Financave	anëtar
Ekspert nga Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë	anëtar
Ekspert nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	anëtar
Ekspert nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	anëtar
Ekspert nga Banka Tregtare	anëtar
Ekspert nga Fakulteti i Ekonomisë	anëtar
Ekspert nga Instituti i Statistikave	anëtar
Ekspert nga Dhoma e Tregtisë	anëtar

3. Bordi i “ALBA-PRO-së” në mbledhjen e tij të parë, të kryejë procedurat e pranimit të anëtarëve të
tjerë të bordit, përfaqësues të sektorit privat.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr.644, datë 18.10.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.775, DATË
28.10.1996 “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT”

Në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, me propozimin e
Ministrisë së Punëve Publike dhe të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.775, datë 28.10.1996, pika 2 ndryshohet si vijon:
“Këshilli Kombëtar për Ujin (KKU) përbëhet nga 9 anëtarë:

-Kryetari i Këshillit të Ministrave	kryetar
-Ministri i Punëve Publike dhe të Transportit	zëvendëskryetar
-Ministri i Pushtetit Lokal	anëtar
-Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit	anëtar
-Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	anëtar
-Ministri i Financave	anëtar
-Ministri i Shëndetësisë	anëtar
-Kryetari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit	anëtar
-Kryetari i Komitetit për Zhvillimin e Turizimit	anëtar

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.589, datë 22.12.1997 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.775, datë 28.10.1996 “Për krijimin e Këshillit Kombëtar të Ujit””, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.647, datë 18.10.1998

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE NË SHËRBIMIN SHËNDETËSOR STOMATOLOGJIK

Në mbështetje të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat”, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Tarifat e shërbimeve shëndetësore, stomatologjike në institucionet shtetërore, ku shërbimi ndaj pacientit nuk subvencionohet nga shteti, të jenë sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Të ardhurat nga zbatimi i këtyre tarifave të derdhen në llogarinë e thesarit, pranë një banke, për llogari të Buxhetit të Shtetit.

2. Këto tarifa të zbatohen në klinikën dentare pranë Qendrës së Shërbimit Mjekësor, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe në kabinetin dentar për diplomatët dhe të huajt e tjerë.

Këto tarifa zbatohen edhe në rastet e hapjes së shërbimeve të reja shëndetësore, stomatologjike, shtetërore për të rriturit.

3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për nxjerrjen e udhëzimit përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE SHTETËRORE STOMATOLOGJIKE TË PASUBVENCIONUARA NGA SHTETI

Trajtime terapeutike	Çmimi në lekë
1. Mbushje gradë II me kompozitë	500
2. Mbushje gradë II me amalgam	280
3. Mbushje gradë III-IV monoradikular me kompozitë	760
4. Mbushje me gradë III-IV monoradikular me amalgam	550
5. Mbushje gradë III-IV multiradikular me kompozitë	980
6. Mbushje gradë III-IV multiradikular me amalgam	800
7. Pastrim gurzash	230

8. Paradontoza	400	
9. Grafia e thjeshtë		85
10. Panoramexi	170	
11. Stomatit		140
12. Gingivit		160

II. Trajtime kirurgjikale

1. Extraxion i dhëmbëve të qumështit	120	
2. Extraxion i thjeshtë	140	
3. Extraxion i vështirë	290	
4. Denticio deficiilis		490
5. Incizion në procesin inflamator		190
6. Operacion ambulator	520	
7. Nevralgjia trigeminale		180
8. Hemoragji pas extraxionit		200
9. Vizitë+ hapje kartelev	50	

V E N D I M

Nr.663, datë 26.10.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.12, DATË 9.1.1993 “PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT TË BANKËS BOTËRORE “PËR LEHTËSIMIN E VARFËRISË SË ZONAVE RURALE””

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në statutin e “Fondit Shqiptar të Zhvillimit”, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.12, datë 9.1.1993 “Për miratimin në parim të projektit të Bankës Botërore “Për lehtësimin e varfërisë së zonave rurale””, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.427, datë 8.9.1994, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.527, datë 12.8.1996, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.324, datë 22.8.1997, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.262, datë 30.4.1998 bëhen këto ndryshime:

Neni 8 ndryshohet si vijon:

“Këshilli drejtues, i cili në vazhdim do të cilësohet “ Këshilli ”, përbëhet nga:

-Zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave dhe

Ministër i Koordinimit Qeveritar

kryetar

-Ministri i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë

anëtar

-Ministri i Pushtetit Lokal

anëtar

-Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit

anëtar

-Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

anëtar

-Zëvendësministri i Financave

anëtar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.674, datë 26.10.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.125, DATË 13.3.1995 “PËR FINANCIMIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR, PËR MASAT PARANDALUESE E MJEKUESE NDAJ SËMUNDJEVE NGJITËSE”

Në mbështetje të nenit 10 të ligjit nr.7761, datë 19.10.1993 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse”, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.125, datë 13.3.1995 “Për financimin e kujdesit shëndetësor, për masat parandaluese e mjekuese ndaj sëmundjeve ngjitëse”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1a fjala “dhe zgjebë” shfuqizohet.
2. Pika 7 ndryshohet si vijon:

“Shpërndarja e barnave për mjekimin dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse bëhet nga shërbimet e epidemiologjisë dhe dispanseritë pranë drejtorive të kujdesit shëndetësor, parësor, pranë drejtorive të shëndetit publik të rretheve dhe nga Drejtoria e Higjienës dhe Epidemiologjisë, Tiranë, në bazë të udhëzimeve dhe të protokolleve të mjekimit që nxjerr Ministria e Shëndetësisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.675, datë 26.10.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.551, DATË 28.8.1998 “PËR VEPRIMET E KTHIMIT TË ARIT TË GRABITUR NGA GJERMANËT GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE”

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.551, datë 28.8.1998 “Për veprimet e kthimit të arit të grabitur nga gjermanët, gjatë Luftës së Dytë Botërore” pika 1 ndryshohet si vijon:

“Sasia e arit prej 49 804,314 (dyzet e nëntë mijë e tetëqind e katër presje treqind e katërmëdhjetë) onc ar i pastër, prej të cilit 31 168,508 (tridhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë presje pesëqind e tetë) onc lingota dhe 18 635,806 (tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë presje tetëqind e gjashtë) onc, në formën e monedhave metalike, dorëzuar Palës shqiptare më 29 tetor 1996 nga komisioni tripalësh dhe sasia prej 1 571,543 (një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një presje pesëqind e dyzet e tre) onc ar i pastër, së bashku me shumën 2 106, 24 (dymijë e njëqind e gjashtë presje njëzet e katër) stërlina angleze, dorëzuar me 13 korrik 1998, të kalojnë në rezervën valutore të Republikës së Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.684, datë 28.10.1998

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 446, DATË 9.7.1998 “PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND TË PAKETAVE SHTETËRORE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË”

Në mbështetje të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.446, datë 9.7.1998 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, bëhen këto ndryshime:

1. Në kapitullin I “Procedura për përcaktimin e formulës së privatizimit”, pas pikës 3C, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“4. Në shoqëritë tregtare, 100 për qind shtetërore, kur ka të dhëna të plota për pjesën e aksioneve për ish-pronarët e truallit dhe për punonjësit e shoqërisë, Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ka të drejtë të përcaktojë paketën e aksioneve, që i ofrohet blerësit dhe të nxjerrë urdhrin përkatës të privatizimit të saj. Ky urdhër i dërgohet Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, për të filluar procedurat për shitjen e këtyre aksioneve”.

2. Në kapitullin II, “Procedura për privatizimin e paketave të aksioneve”, në pikën 1, fjalia e dytë ndryshohet si vijon:

“Afati i publikimit do të jetë 30 ditë”.

3. Në kapitullin II, “Procedura për privatizimin e paketave të aksioneve”, në pikën 9, fjalia e fundit ndryshohet si vijon:

“Në vazhdim, procedura rifillon nga pika 1, kapitulli II i këtij vendimi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.687, datë 18.10.1998

PËR MASËN E SHPËRBLIMIT QË U JEPET SHTETASVE TË NDRYSHËM TË CILËT JAPIN INFORMACION PËR GRUMBULLIMIN E ARMËVE DHE TË MUNICIONEVE LUFTARAKE

Në mbështetje të nenit 13 të ligjit nr.8388, datë 5.8.199 “Për grumbullimin e armëve dhe të municioneve luftarake”, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Organet e policisë vlerësojnë e verifikojnë të dhënat për sasinë e armëve dhe të municioneve të fshehura që jepen nga burime të ndryshme informacioni.

2. Individët ose personat juridikë, që japin informacion të saktë për sasi të mëdha armësh dhe

municionesh, shpërblehen në masën 5 për qind të sasisë së zbuluar, pas magazinimit të mallit.

3. Shpërblimi jepet nga drejtuesi i policisë së prefekturës ose i komisariatit, në praninë e punonjësit të policisë, i cili ka marrë informacionin.

4. Informacioni për vendndodhjen e armëve dhe të municioneve përbën sekret shtetëror.

5. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga të ardhurat e Ministrisë së Rendit Publik, të realizuara nga shitja e mallrave kontrabandë, të konfiskuara sipas pikës 3/1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.593, datë 22.12.1997 “Për zbatimin e ligjit nr.8262, datë 15.12.1997 “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr.7599, datë 2.9.1992””, “Për Kodin Doganor”, ndryshuar me ligjin nr.8020, datë 1.11.1995, ndryshuar me dekretin nr.1578, datë 13.8.1996”, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.658, datë 18.10.1998.

6. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ministria e Rendit Publik të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.688, datë 26.10.1998

PËR LEJIMIN E DHËNIES SË NJËHERSHME TË NDIHMËS EKONOMIKE PËR ZONAT QË BLOKOHEN NË PERIUdhËN E DIMRIT

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe të nenit 7 e 10 të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejohet dhënia në mënyrë të njëhershme e ndihmës ekonomike për një periudhë deri në 2 muaj, për zonat e thella, të cilave u vështirësohet komunikimi dhe bllokohen gjatë periudhës së dimrit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale që në bashkëpunim me organet e pushtetit lokal të ndjekë dhe të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

Rrethet dhe komunat që izoloohen nga dimri

Rrethi Shkodër

Komunat

Nr. banorë

Nr. familjeve në
ndihmë

Pult	3900	934
Shoshë	1900	353
Shalë	5800	1119
Shllak	1900	370
Temal	2700	495
Shuma		3271

Rrethi Dibër

Komunat

Lurë	2975	494
Selishtë	4295	497
Zallreç	3175	325
Kalaja e Dodës	5029	805
Sllovë	6632	750
Shuma		2871

Rrethi Bulqizë

Komunat

Martanesh	1153	282
Zerqan	1767	357
Shupenzë	3954	702
Ostren	5771	523
Klenjë	2282	206
Shuma		2070

Rrethi Mat

Komunat

Suç	2300	236
Ulëz	1200	188
Baz	3625	123
Komsi	1300	316
Rukaj	3200	366
Derjan	3505	256
Macukull	4242	430
Lis	800	305
Gurë	4841	383
Xibër	4327	568
Shuma		3171

Rrethi Kukës

Komunat

Surroj	3997	353
Shtiqen	4070	383
Bicaj	7749	983
Ujmishtë	4037	0
Bushttricë	3870	558
Aren	2127	328

Malzi	7172	486
Kolsh	2217	121
Terthorë	3997	397
Orgjost	3577	471
Topojan	4870	521
Shishtavec	6890	915
Grykë e Cajës	2630	462
Kalis	3295	580
Shuma		6558

Rrethi Hasit

Komunat

Golaj	8729	384
Fajza	4370	387
Gjinaj	1901	289
Shuma		1060

Rrethi Tropojë

Komunat

Bujan	3076	371
Bytyç	3697	322
Fierzë	1377	354
Lekbibaj	5288	626
Margegaj	1713	471
Tropojë	3347	648
Shuma		2792

Rrethi Mirditë

Komunat

Kaçinar	1729	366
Orosh	2879	415
Fan	6353	645
Selitë	1983	362
Shuma		1788

Rrethi Librazhd

Komunat

Rajcë	1520	730
Polis	1950	0
Stravaj	1440	294
Steblevë	2520	169
Orenjë	2420	784
Lunik	800	279
Shuma		2256

Rrethi Malësi e

Madhe

Komunat

Kelmend	6400	1021
Shkrelë	2720	600
Gruemirë	360	205
Kastrat	2050	507
Shuma		2333

Rrethi Pukë

Komunat

Qerret	6063	667
Qelez	3900	341
Rrapë	6232	283
Qafë Mali	6936	319
Gjegjan	6510	556
Blerim	3720	245
Iballë	4679	495
Fierzë	3904	537
Shuma		3443
Totali		31613

V E N D I M

Nr.693, datë 26.10.1998

PËR PROCEDURËN E REALIZIMIT TË TË ARDHURAVE NGA TATIMI MBI NDËRTESAT

Në mbështetje të ligjit nr.7805, datë 16.3.1994 “Për tatimin mbi pasurinë në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.7930, datë 11.5.1995, ndryshuar me ligjin nr.8344, datë 13.5.1998, me propozimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Të përgjithshme

1. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Punëve Publike dhe e Transportit dhe kryeregjistruesi i pasurive të paluajtshme të paraqesin në Ministrinë e Pushtetit Lokal të dhënat që disponojnë për dokumentacionin për tatimin mbi ndërtesat, si dhe të udhëzojnë organet e tyre në rrethe për të bashkëpunuar me organet e pushtetit lokal për realizimin e këtij tatimi.

2. Ministria e Pushtetit Lokal organizon strukturat për administrimin e vjeljes së tatimit mbi ndërtesat. Për këtë qëllim, të bëhet kalimi i strukturave përkatëse të personelit që punon për tatimin mbi pasurinë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në Ministrinë e Financave, te Ministria e Pushtetit Lokal dhe organet e pushtetit lokal.

3. Në komuna e bashki të ngrihen zyrat e tatim-taksave. Shpenzimet për pagat e punonjësve dhe shpenzimet operative të tyre të përballohen nga të ardhurat që realizon pushteti lokal. Numri i punonjësve në këto zyra caktohet nga këshillat përkatëse të pushtetit lokal, në varësi të vëllimit të punës që mbulojnë dhe të ardhurave të realizuara.

II. Për procedurën e realizimit të tatimit mbi ndërtesat

1. Bashkitë dhe komunat brenda muajit shkurt të çdo viti, kërkojnë nga zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, listën e personave fizikë a juridikë, vendas a të huaj, që kanë në pronësi ndërtesa, në të cilat tregohet edhe sipërfaqja e ndërtimit dhe destinacioni i përdorimit të tyre, në përputhje me ligjin nr.7805, datë 16.3.1994.

2. Bashkia ose komuna kërkon nga të gjithë personat juridikë, publikë dhe institucionet shtetërore të dhëna për ndërtesat dhe sipërfaqet e ndërtimit që kanë në administrim. Këto të fundit, detyrohen t'i dërgojnë të dhënat brenda muajit shkurt të çdo viti.

3. Komuna ose bashkia, me komisione të ngritura nga kryetari i tyre, bëjnë evidentimin me procesverbalet dhe azhurnimet e nevojshme në terren për të gjitha ndërtesat në pronësi ose në përdorim, të personave fizikë a juridikë, vendas a të huaj, që ndodhen në territorin e juridiksionit të tyre, për të cilët nuk kanë të dhëna të dokumentuara.

4. Bashkia ose komuna, kur e gjykon të nevojshme, kërkon nga dega e tatim-taksave të rrethit, të dhëna për subjektet që janë objekt i tatimit mbi ndërtesat.

5. Bashkia ose komuna, pasi harton listën e plotë të subjekteve të tatueshme për ndërtesat, në përputhje me klasifikimin e përcaktuar në ligjin nr.7805, datë 16.3.1994, brenda 15 marsit të çdo viti, përllogarit tatimin mbi ndërtesat për çdo person fizik a juridik, vendas a të huaj, regjistron detyrimin tatimor për secilin prej tyre në regjistrin e veçantë të detyrimit tatimor mbi ndërtesat dhe plotëson akt-detyrimin përkatës në tri kopje. Një kopje e akt-detyrimit mbahet në dosjen përkatëse të tatimpaguesit, një kopje i dërgohet tatimpaguesit dhe një kopje tjetër, kur bëhet fjalë për qytetin, i dërgohet agentit tatimor, ndërmarrjes elektrike, ndërsa për fshatin, kopja i dërgohet zyrës së financave të bashkisë ose komunës përkatëse.

6. Paga e detyrimit të tatimit mbi ndërtesat, në qytetet e bashkive ose të komunave, bëhet pranë ndërmarrjeve elektrike ose filialeve të tyre në këto qytete. Për fshatrat, qofshin këto të bashkive ose komunave, paga bëhet pranë zyrave të financës së bashkisë ose komunës përkatëse. Tatimpaguesi me marrjen e njoftimit, është i detyruar të paraqitet, përkatësisht, në zyrën e financës së komunës ose në ndërmarrjen elektrike, për shlyerjen e detyrimit në afatin e caktuar. Arkëtimi i vlerave të detyrimit tatimor për çdo tatimpagues, bëhet sipas kësteve të përcaktuara në akt-detyrim.

Vlera e arkëtuar regjistrohet në ditarin e arkës dhe tatimpaguesit i dokumentohet paga e kryer në librezën e pagesës së tatimit mbi ndërtesat. Modeli i librezës hartohet nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe prodhimi i saj përballohet nga Buxheti i Shtetit. Deri në plotësimin e tatimpaguesve me librezë, arkëtimi i detyrimit bëhet me mandat-arkëtimi, i cili përpilohet në 3 kopje, të cilat mbahen, përkatësisht, nga tatimpaguesi, nga zyra e tatimtaksave në bashki ose komunë, kopje e cila depozitohet në dosjen përkatëse të tatimpaguesit, ndërsa kopja e tretë i bashkëlidhet dokumenteve të arkës në zyrën e financës së bashkisë ose komunës.

Çdo ditë, shumat e detyrimit tatimor, të arkëtuara nga agjenti tatimor, derdhen totalisht në degën e thesarit nëpërmjet degëve të bankës e filialeve të saj ku ka llogari thesari ose nëpërmjet zyrave postare.

Tatimpaguesit mund të bëjnë shlyerjen e detyrimit për tatimin mbi ndërtesat edhe në llogarinë e thesarit të bashkisë a komunës, nëpërmjet degëve të bankës ose filialeve të saj, ku ato kryejnë veprime

III. Të përbashkëta

1. Në fund të çdo muaji të bëhet rakordimi ndërmjet komunave, bashkive, këshillit të rrethit, degës së thesarit dhe degës së buxhetit të rrethit, për nivelin e realizimit të tatimit mbi ndërtesat. Dega e buxhetit në rrethe bën shpërndarjen e të ardhurave të arkëtuara nga tatimi mbi ndërtesat për çdo organ të pushtetit lokal, në masën e përcaktuar në ligjin vjetor të Buxhetit të Shtetit.

2. Degët e thesarit në rrethe në përfundim të procesit të rakordimit me organet e pushtetit lokal, për realizimin e të ardhurave nga tatimi mbi ndërtesat, 5 për qind të këtyre të ardhurave ia kalojnë agjentit tatimor dhe 5 për qind këshillave të rretheve.

3. Organet e pushtetit lokal, përveç depozitimit të buxhetit të miratuar për to, paraqesin periodikisht, në prefekturë dhe në Ministrinë e Pushtetit Lokal relacionin për të ardhurat e realizuara nga tatimi mbi ndërtesat dhe shpenzimet e përballuara me këto të ardhura.

4. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Financave dhe prefekturat për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr.702, datë 3.11.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 595, DATË 29.12.1993 “PËR KRITERET E SHPALLJES SË KONKURSEVE ME KARAKTER KOMBËTAR E LOKAL DHE DHËNIEN E ÇMIMEVE PËR TO”

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.595, datë 29.12.1993 “Për kriteret e shpalljes së konkurseve me karakter kombëtar e lokal dhe dhënien e çmimeve për to”, paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si vijon:

“Shpallja e konkurseve në fushën e kulturës, artit dhe sportit në shkallë kombëtare dhe dërkombëtare, bëhet nga ministria dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse, ndërsa për ato në shkallë lokale nga këshillat e rretheve dhe bashkitë e qyteteve”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr.723, datë 19.11.1998

Në zbatim të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, ndryshuar me ligjin nr.8052, datë 21.12.1995, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përfitojnë rimbursimin e shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe të lubrifikanteve, invalidët që kanë mjete motorike për invalidë.
2. E drejta e invalidëve për të përfutur rimbursimin e shpenzimeve, për blerjen e karburanteve dhe të lubrifikanteve, përcaktohet nga komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe organeve rajonale në varësi të tij, sipas kriterëve të përcaktuara nga ky Institut.
3. Shuma mujore e rimbursimit të shpenzimeve për blerjen e karburanteve e të lubrifikanteve është 2 200 lekë.
4. Pagesa e shumave mujore të rimbursimit të shpenzimeve për blerjen e karburanteve e të lubrifikanteve, të realizohen çdo muaj nga zyrat e sigurimeve shoqërore në rrethe, me paraqitjen e librezës së invaliditetit dhe të vërtetimit të posaçëm, të lëshuar nga komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë.
5. Efektet financiare, në masën 8 300 000 (tetë milionë e treqind mijë) lekë në vit, për zbatimin e këtij vendimi, të përballohen nga Buxheti i Shtetit dhe të programohen çdo vit në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
6. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore

për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.48, datë 14.2.1994 “Për çmimet e shitjes së karburanteve për invalidët paraplegjikë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1.1.1999.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.725, datë 19.11.1998

PËR PRIVATIZIMIN E BANKËS KOMBËTARE TREGTARE, SH.A.

Në mbështetje të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Të privatizojë shoqërinë anonime “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a..

Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.726, datë 19.11.1998

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Koeficientët e shtesës së bazës së vlerësueshme vjetore, individuale për llogaritjen fillestare të pensioneve, në mbështetje të pikës 3 të nenit 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të jenë:

-Për vitin 1997 koeficienti të jetë	1
-Për vitin 1996 koeficienti të jetë	$1 \times 1.09 = 1.09$
-Për vitin 1995 koeficienti të jetë	$1 \times 1.09 \times 1.37 = 1.49$
-Për vitin 1994 koeficienti të jetë	$1 \times 1.09 \times 1.37 \times 1.32 = 1.97$

2. Organet e sigurimeve shoqërore, për pensionet me datë fillimi 1.1.1997 e në vazhdim, që janë në veprim, të rillogarisin masën e pensionit duke shtuar bazën e vlerësueshme, individuale për vitet e sipërme me koeficientët e pikës 1. Për pensionet e mbyllura, të caktuara me datë fillimi 1.1.1997 e në vazhdim, rillogaritja

do të bëhet vetëm me kërkesën e të interesuarit ose të familjarëve.

3. Efektet financiare për mbulimin e shtesës së masës së pensioneve, si rrjedhojë e zbatimit të koeficientëve të pikës 1, të përballohen nga fondi i ISSH-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.727, datë 19.11.1998

PËR KRIJIMIN E KOMITETIT TË SIGURISË SË AVIACIONIT CIVIL PËR AEROPORTIN

Në mbështetje të nenit 15 të ligjit nr.8310, datë 19.3.1998 “Për sigurinë në aviacionin civil shqiptar”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijohet Komiteti i Sigurisë së Aviacionit Civil për aeroportin, për zhvillimin, bashkërendimin dhe zbatimin e masave të sigurimit, të procedurave në aeroport.

2. Komiteti i Sigurisë së Aviacionit Civil për aeroportin përbëhet nga:

Drejtori i aeroportit	kryetar
Shefi i rajonit të policisë, Rinas	zëvendës
	kryetar
Shefi i imigrimit të aeroportit	anëtar
Drejtori i ANTA-së	“
Drejtori i doganës së aeroportit	“
Komandanti i regjimentit 4020 të aeroportit	“
Përgjegjësi i zjarrfikësve të aeroportit	“
Përgjegjësi i sektorit të sigurisë pranë Drejtorisë së	“
Përgjithshme të Aviacionit Civil	
Përgjegjësi i sigurisë së aeroportit	“
Kryetari i bordit të kompanive ajrore, që operojnë në	“
aeroport	

3. Komiteti i Sigurisë së Aviacionit Civil për aeroportin mbledhet rregullisht çdo 2 muaj, me kërkesën e kryetarit ose në raste të veçanta, me kërkesën e çdo anëtari të këtij komiteti.

4. Komiteti i Sigurisë së Aviacionit Civil për aeroportin ka për detyrë:

a) të marrë masat e duhura për zbatimin e legjislacionit në fuqi në fushën e sigurisë së aviacionit civil shqiptar;

b) të raportojë pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Aviacionit Civil për nivelin e sigurisë në aeroport, masat e marra dhe ato që duhen marrë për të arritur nivelin e kërkuar, si dhe për çdo problem që lidhet me sigurinë në aeroport e që dalin jashtë kompetencave të këtij Komiteti.

c) të programojë dhe të ndjekë planin e kualifikimeve, të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, për kualifikimin e personelit të aeroportit dhe të organizmave të tjerë, që veprojnë në të.

5. Komiteti i Sigurisë së Aviacionit Civil për aeroportin merr masa për të bashkërenduar zbatimin e akteve nënligjore, të dala në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe që kanë për qëllim përmirësimin e procedurave të sigurisë në aeroport.

6. Komiteti i Sigurisë së Aviacionit Civil për aeroportin merr masa për të zbatuar, me përpikëri, procedurat e parashikuara në planin e rasteve të jashtëzakonshme, të miratuara nga institucionet përkatëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në aeroport.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr.728, datë 19.11.1998

PËR HAPJEN E FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR XHUVANI” TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 11 të ligjit nr.7810, datë 6.4.1994 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Hapjen e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit.
 2. Në këtë fakultet bëjnë pjesë degët: anglisht, frëngjisht, gjermanisht.
 3. Efektet financiare, që burojnë nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për universitetin për vitin 1998.
 4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr.730, datë 19.11.1998

PËR MIRATIMIN E RRYTJES SË KUOTËS TË ANËTARËSIMIT NË FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të ligjit nr.7515, datë 1.10.1991 “Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim, në Korporatën Financiare Ndërkombëtare, në Shoqatën e Zhvillimit Ndërkombëtar, në Agjencinë e garantimit të investimeve shumëpalëshe dhe në Qendrën ndërkombëtare për zgjidhjen e konflikteve në investimet”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të miratojë rritjen e kuotës së anëtarësimit të Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar nga 35 300 000 (tridhjetë e pesë milionë e treqind mijë) SDR në 48 700 000 (dyzet e tetë milionë e shtatëqind mijë) SDR.
 2. Shtesa e kuotës prej 13 400 000 (trembëdhjetë milionë e katërqind mijë) SDR, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të mbulohet nga kredia e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe nuk do të jetë element i shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit.
 3. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për shtesën e kuotës së anëtarësimit në Fondin Monetar Ndërkombëtar, sipas pikës 1 të këtij vendimi.
- Ngarkohet Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M

Nr.743, datë 27.11.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.235, DATË 15.5.1995 “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË RRUGËVE”

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.235, datë 15.5.1995, pika 2 ndryshohet si vijon:

“Këshilli Kombëtar i Rrugëve” drejtohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe përbëhet nga:

-Ministri i Punëve Publike dhe të Transportit	anëtar
-Ministri i Pushtetit Lokal	anëtar
-Ministri i Tregtisë dhe i Bashkëpunimit Ekonomik	anëtar
-Zëvendësministri i Financave	anëtar
-Zëvendësministri i Rendit Publik	anëtar
-Drejtori i Drejtorisë së Rrugëve	anëtar
-Pesë specialistë	anëtarë

Specialistët caktohen nga Kryetari i Këshillit të Rrugëve, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike e të Transportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

fund

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor,2002
	Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarrimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	

U dorëzua për shtyp më 19. 9. 2003
Doli nga shtypi më 11.4. 2003

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë